

MENDIM PAKICE

1. Unë, komisionere Brunilda Bekteshi, si anëtare e trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e marrë nga shumica e trupit gjykues, për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Besnik Maho, e cila ka disponuar me përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar, për shkak se, sipas mendimit të pakicës, z. Maho plotëson kriteret ligjore për t'u vetuar sipas parashikimeve ligjore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në nenin 179/b, pika 4, si dhe ligjin nr. 84/2016, në nenin 3, pika 16. Ky qëndrim bazohet në faktet e konstatuara në analizën juridike dhe vlerësimet për sa do të arsyetohet në vijim.

2. Kushtetua në nenin 179/b, pika 4, si dhe ligji nr. 84/2016, në nenin 3, pika 16, kanë përcaktuar se procesit të rivlerësimit kalimtar, sipas ligjit të posaçëm nr. 84/2016, mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët, ish-prokurorët, ish-këshilltarët ligjorë të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet.

3. Rezulton se z. Besnik Maho, pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ka dorëzuar në datën 31.1.2017, në ILDKPKI kërkesën për t'u vetuar, me arsyetimin se në vitet 2004 – 2007 ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec. Bashkë me këtë kërkesë ai ka dorëzuar dhe deklaratën *Vetting* 2017.

4. Rezulton se kërkuesi ka plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional duke e dorëzuar pranë ish-KLD-së dhe atë të kontrollit të figurës, dorëzuar pranë DSIK-së. Ndërkohë që, kërkesa drejtuar ish-KLD-së dhe DSIK-së përfshin edhe kërkesën për rivlerësimin e pasurisë.

Analiza ligjore e fakteve të konstatuara në raport me dispozitën kushtetuese në lidhje me legjitimitetin e kërkuesit për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

5. Kushtetua në nenin 179/b, pikat 3 dhe 4, parashikon: “3. Të gjithë gjyqtarët [...] i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*... 4. Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët..., të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën 3 vjet”.

6. Sipas vlerësimit tim ligjor të referuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit, pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës i referohet të gjithë gjyqtarëve, të cilët e mbajnë statusin e magjistratit/gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ndërsa fjalia e dytë e paragrafit 4 iu referohet ish-gjyqtarëve që nuk e kanë statusin, por kanë punuar të paktën 3 vjet në këto pozicione dhe nëpërmjet kërkesës, pasi të kalojnë procesin e rivlerësimit mund të rikthehen në sistem, **pra diferenca midis cilësisë së gjyqtarit dhe ish-gjyqtarit, është statusi i magjistratit në momentin e hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave**¹.

7. Referuar rrethanave të sipërcituara të çështjes vlerësoj se përpara Komisionit është shtruar për zgjidhje çështja “Nëse z. Besnik Maho i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar” sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës.

¹ Vendimi nr. 46, datë 1.12.2022, (JR) i Kolegjit, (pg.16.1).

8. Në drejtim të përmbushjes së kriterëve ligjore që kërkon pika 4 e nenit 179/ b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në gjykimin tim, verifikimet e Komisionit brenda kompetencës së tij kishin dhe kanë të bëjnë me tri aspekte:

8.1 Verifikimit të faktit nëse subjekti ka paraqitur kërkesë për t'u vetuar si ish-gjyqtar. Lidhur me këtë kërkesë të ligjit, nga aktet në dosje rezulton se subjekti ka paraqitur kërkesë në datën 31.1.2017, duke kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, si dhe ka plotësuar edhe formularët përkatës sipas neneve 31/3 dhe 35/5 dhe sipas pikës 2 të nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

8.2 Verifikimit të vullnetit të subjektit lidhur me këtë kërkim ligjor. Nga aktet në dosje të administruara përgjatë procesit provohet shprehja e vullnetit të tij për t'u vetuar si ish-gjyqtar.

8.3 Verifikimit si aspekti thelbësor, që subjekti të plotësojë kriteret sipas ligjit, pra të ketë punuar të paktën 3 vjet si gjyqtar.

8.3.i Lidhur me këtë kërkesë të ligjit, nga analiza e fakteve të administruara në dosjen e subjektit, në raport me ligjin e zbatueshëm, si pakicë kam çmuar se subjekti i plotëson 3 vite pune si gjyqtar, pasi nga aktet në dosje ka rezultuar e provuar se:

a. Nga dokumentacioni i administruar nga KLGJ-ja rezulton se z. Besnik Maho me Dekretin e Presidentit datë 17.9.2004 është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional.

b. Më pas, me Dekretin e datës 3.10.2005 është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në datën 19.6.2007, kur KLD-ja ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirim nga detyra të gjyqararit. Vlerësoj se cilësinë, pra qenien “magjistrat/gjyqtar” subjekti e ka fituar në momentin e emërimit në detyrë, sipas procedurave që ndiqen nga organi kompetent. Në momentin që një gjyqtar emërohet në detyrë gëzon status të veçantë, *i cili përfshin garancitë për palëvizshmërinë nga detyra, mbrojtje të veçantë nga shteti për vete, familjen dhe pronën, gëzon një pagë që nuk mund të ulet/cenohet, cilësia e gjyqararit mbaron vetëm me akt të organit të përcaktuar me ligj dhe për shkaqet e përcaktuara ligjore, po ashtu me këtë status i vinin edhe detyrimet, që përfshijnë papajtueshmërinë, ndër të tjera, edhe me funksione politike e private.*

c. Për sa më sipër, në vlerësimin tim, periudha e ushtrimit të detyrës si gjyqtar nga muaji shtator 2004 e në vijim duhet të përfshihet/përlllogaritet në kriterin ligjor të periudhës trevjeçare që kërkohet prej nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës. Në këtë vlerësim, pavarësisht se shumica ka arsyetuar në mënyrë alternative, unë çmoj se periudha e stazhit duhet të llogaritet në afatin trevjeçar që kërkon Kushtetuta në nenin 179/b, pika 4, pasi për efekt të parashikimit të nenit 21² të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, z. Maho gjatë periudhës së stazhit profesional gëzonte të drejta dhe kishte detyrime njësoj si magjistratët. Ashtu sikurse subjekti ka deklaruar se gjatë kësaj periudhe ka dhënë 200 vendime, në vlerësimin tim ushtrimi i kësaj detyre në këtë periudhë e barazon me ushtrimin e detyrës së gjyqararit pa asnjë kufizim me gjyqtarët e tjerë, duke arsyetuar e nënshkruar vendime në *emër të Republikës*. Në vlerësimin tim, referimi i shumicës në vendimin e Kolegjit, nr. 39, datë 25.10.2022 (E. M. N.), nuk është relevante për çështjen objekt vlerësimi, pasi ka të bëjë me vlerësimin e atij grupi magjistratësh që u emëruan në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit kjo çështje për këta magjistratë është vlerësuar në raport me dispozitat e reja që rregulluan në mënyrë të posaçme statusin dhe

² Përcakton se: “Gjatë periudhës së stazhit profesional kandidatët gëzojnë të drejta dhe kanë detyrime njëjloj si magjistratët”.

kontrollin e këtij grupi magjistratësh³, duke e nxjerrë nga juridiksioni rivlerësues dhe duke ia lënë juridiksionit të zakonshëm sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016.

8.3.ii Në vijim të analizimit të përmbushjes së afatit trevjeçar ka rezultuar se z. Maho nga data 28.6.2007 deri në datën 21.5.2008 ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

a. Lidhur me ushtrimin e kësaj detyre konstatohet se në datën 13.6.2007 z. Besnik Maho ka paraqitur pranë KLD-së kërkesën për t'u dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit dhe miratimin e kërkesës për t'u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë.

b. Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. *** prot., datë 18.6.2007, i ka kërkuar ish-KLD-së të miratojë kërkesën për dorëheqje të z. Besnik Maho dhe dhënien e pëlqimit për kalimin e tij me detyrë pranë Ministrisë së Drejtësisë me argumentin se angazhimi i tij në nivelet drejtuese të strukturave juridike të Ministrisë së Drejtësisë **nuk e zhvesh gjyqtarin Besnik Maho nga statusi.**

c. KLD-ja, me vendimin nr. ***, datë 19.6.2007, ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirim nga detyra të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec.

ç. Për sa i përket gjyqtarëve që shërbenin në strukturat juridike të Ministrisë së Drejtësisë rezulton se ligji nr. 8436/1998 parashikonte se *gjyqtarët mund të shërbejnë në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë dhe kjo periudhë njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale*⁴. Gjithashtu dhe ligji nr. 9877/2008 parashikonte se *gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të KLD-së mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë*. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës dhe periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. Ky parashikim zbatohet edhe për ata gjyqtarë që kanë shërbyer në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë para hyrjes në fuqi të këtij ligji⁵.

d. Nga informacioni i administruar nga KLGJ-ja rezulton se në datën 13.9.2013 z. Maho ka paraqitur kërkesë në KLD për t'u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, duke pasqyruar ndërmjet të tjerave si shkak se në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 8678/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë" i lind e drejta të kërkojë rikthimin në sistemin gjyqësor. Referuar raportit nr. *** prot., datë 11.12.2013, të KLD-së, "Mbi rezultatet e

³ Kolegji çmon se kontrolli dhe vlerësimi i ankueses, nuk është një proces që duhet t'i nënshtrohet parashikimeve për procesin e rivlerësimit, por ajo i takonte juridiksionit të zakonshëm, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mungesë të juridiksionit të rivlerësimit ndaj ankueses, veprimtaria e Komisionit, si një prej organeve të rivlerësimit, është kryer në tejkallim të juridiksionit të tij kushtetues e ligjor dhe, për pasojë, disponimet e bëra prej tij në vendim duhet të mbeten pa fuqi ligjore dhe të mos kenë efekt mbi karrierën e mëtejshme të magjistrates, e cila duhet t'i nënshtrohet rregullave të legjislacionit të përgjithshëm edhe për këtë pjesë.

⁴ Neni 30/a (shtuar me ligjin nr. 8656, datë 31.7.2000) parashikon se: "Gjyqtarët mund të shërbejnë në nivele drejtuese të kabinetit të Ministrisë dhe strukturave juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë. Periudha e shërbimit civil të tyre në këto struktura njihet periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat e ligjeve për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe të Prokurorisë. Gjyqtarët që shërbejnë si nëpunës civilë në Ministrinë e Drejtësisë, me kërkesë të tyre, rëmërohen gjyqtarë pa konkurs.

⁵ Ligji nr. 9877/2008, neni 28 parashikon se: "1. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmës ligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të gjykatës së apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës... 3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale. 4. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion edhe për ata gjyqtarë, të cilët kanë shërbyer në institucionet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

pikëzimit të kandidatëve për 13 vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor”, rezultoi se z. Besnik Maho figuron në renditje të parë në listën e kandidatëve “jo gjyqtarë magjistratë”.

8.4 Referuar këtyre fakteve dhe analizës së mësipërme ligjore, vlerësoj se z. Maho e ka ruajtur statusin gjatë ushtrimit të detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, si strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, të cilën e ka fituar ligjërisht prej fillimit të detyrës si gjyqtar. Nga ana tjetër rezultoi se në momentin e shkarkimit të z. Maho, në datën 21.5.2008, kishte hyrë në fuqi ligji nr. 9877/2008, i cili parashikonte se në përfundim të afatit të ushtrimit të detyrës në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës dhe sipas ligjit nr. 8678/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, këto subjekte paraqesin kërkesë dhe riemërohen përsëri gjyqtarë pa konkurs, porse këto ligje në dispozitat e tyre nuk kanë parashikuar ndonjë afat brenda të cilit gjyqtari që ka punuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë duhet të paraqesë kërkesën për t’u riemëruar si gjyqtar. Nga aktet e administruara rezultoi se z. Maho kishte depozituar kërkesë për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, në vitin 2013. Po nga aktet e administruara rezultoi se KLGJ-ja ka përcjellë procesverbalin e mbledhjes së datës 16.12.2013, ku nga verifikimi përkatës nuk rezultoi që ky organ të ketë marrë në shqyrtim kërkesën e z. Maho për t’u rikthyer si gjyqtar dhe as ka rezultuar në ndonjë kontestim lidhur me humbjen e statusit. Në vlerësimin tim nuk duhet cenuar analiza ligjore e përmbushjes së afatit trevjeçar si një ndër kriteret që z. Maho duhet të përmbushte në raport me kërkesat e nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

8.5 Analiza ligjore e cituar më sipër gjen mbështetje edhe për sa rezultoi në dokumentin “Raporti nr. *** prot., datë 11.12.2013, të KLD-së”, i cili ka verifikuar përmbushjen e kriterëve ligjore të secilit kandidat për vendet vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku konstatohet se ish-KLD-ja në vlerësimin e kandidatëve të paraqitur e ka cilësuar z. Maho në dokumentin bashkëshoqërues të raportit, tabela nr. ***, me numër rendor ***, **me vjetërsi në profesion 3 vjet.**

9. Lidhur me arsyetimin e shumicës për sa i përket ruajtjes ose jo të statusit të magjistratit, në mendimin tim si pakicë vlerësohet se kjo çështje është jashtë objektit të kërimit, në referim të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016, neni 3, pika 16, ku procesi i rivlerësimit në rastin objekt shqyrtimi ka fokusin te kërkitimi i subjektit për t’u vetuar si ish-gjyqtar, që me këtë cilësi nuk kërkohet pasja e statusit për efekt të procesit të rivlerësimit. Në vlerësimin tim, argumentet e shumicës për të mos njohur statusin e z. Maho, duke marrë në konsideratë faktin se Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional të KLGJ-së konfirmon se z. Maho nuk e ka statusin e magjistratit dhe se ai e ka humbur atë për shkak të ligjit (*ex lege*), janë jashtë objektit të vlerësimit ligjor të trupës gjyqësore të Komisionit, në raport me kërkitimin e z. Maho, për arsye të mëposhtme:

9.1 Pasja e statusit është një kërkesë e domosdoshme e ligjit vetëm për rastet e subjekteve sipas nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilët i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. Në çështjen objekt vlerësimi nuk jemi përpara këtij rasti.

9.2 Dokumenti “Kthim përgjigje” i Sekretarit të Përgjithshëm të KLGJ-së, pavarësisht se është shprehur për humbjen e statusit **aktual** të z. Maho dhe, pavarësisht se ai nuk është akti ligjor në formën e kërkuar nga ligji nr. 96/2016, që parashikon mënyrën dhe procedurën që ndiqet

për dhënien e vendimit të pasjes ose jo të statusit⁶, rezulton se ka evidentuar faktin se z. Maho ka kërkuar të vetohet si ish-gjyqtar.

10. Në mbështetje të mendimit tim si pakicë se subjekti ka përmbushur kriterin e pasjes së 3 viteve të punës së tij si gjyqtar, vlerësoj se për analogji kjo periudhë do të përlllogaritej dhe do të shërbente në përmbushjen e kriterëve të z. Maho nëse ai do të ishte një kandidat për të ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Lartë.

11. Në konkluzion, për shkaqet e analizuara sa më lart kam vlerësuar se konkludimi i shumicës së trupit gjykues, duke deklaruar përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për z. Besnik Maho, nuk gjen mbështetje në faktet e dala dhe parashikimet ligjore të cituara më sipër. Në vlerësimin tim, procesi i rivlerësimit për këtë subjekt duhej përfunduar me vendim përfundimtar, referuar nenit 166, pikat 1 e 3 të ligjit nr. 96/2016 dhe, në zbatim të nenit 58, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon se: *“Në rast se subjektet e rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës, kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit, Komisioni mund të vendosë:*

- a) emërimin si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve;
- b) refuzimin e emërimit si gjyqtar ose prokuror, në përputhje me dispozitat e legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Brunilda BEKTESHI
Anëtare (kundër)

⁶ Vendimi i pasjes ose jo të statusit jepet me vendim të KLGJ-së.